



Monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Fier

VITI 2019

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në familje të “Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Womendhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, dhe nuk reflekton opinionin e SIDA, UNDP, UNFPA dhe UN Women.

Autore

Alketa Dhimitri- Qendra Rinore Vlorë

Nevila Jahaj - Epoka e Re, Fier

Esmeralda Hoxha – Qendra “Aleanca Gjinore për zhvillim”

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	5
PËRSE MONITORIM I SKBGJ-SË NGA OSHC-TË?	6
METODOLOGJIA	6
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	8
GJETJET KRYESORE	8
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË FIER	9
TË DHËNA NGA DREJTORIA VENDORE E POLICISË, BASHKIA FIER	10
TË DHËNAT NGA GJYKATA E RREHIT GJYQËSOR FIER.....	11
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2019	11
KONKLUZIONE	17
REKOMANDIME NË BAZË TË MONITORIMIT TË PUNËS KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE NË BASHKINË FIER	17

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
GTN	Grupi Teknik Ndërdisiplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAË	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QAGjzh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZhK “Sot për të Ardhmen”	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Ky raport u hartua në kuadër të Projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të OShC-ve për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve në lidhje me zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, nën Programin e Përbashkët të KB "Përfundimi i Dhunës ndaj Grave" të financuar nga Qeveria e Suedia po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë shqiptare Në Shqipëri projekti u zbatua nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, nga disa nga anëtarët e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri dhe disa organizata të tjera joqeveritare. Bashkitë e përfshira në monitorim ishin bashkitë e Lezhë, Kamëz, Fier, Sarandë dhe Pogradec.

Qëllimi i projektit është monitorimi i i detyrimeve ndërkombëtare dhe kombëtare të Shqipërisë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Proçesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2016-2020 pr bashkitë e lartpërmenduar u zhvillua përgjatë periudhës nëntor 2019- Maj 2020. Aktivitetet në nivel qendror u monitoruan nga QAGjZh dhe në nivel lokal nga disa prej anëtarëve të RrFGSh i dhe disa organizata të tjera, përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin të Qëllimit strategjik 3 të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020.¹

Gjatë zbatimit të projektit u arrit që:

1. Organizatat partnere në projekt të rrisin për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020 dhe punën e mekanizmave të referimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
2. Proçesi i monitorimit nga u përfundua me sukses brenda afateve të zbatimit të projektit pasi edhe pse nën ndikimin e krizës COVID-19, institucionet përgjegjëse dërguan në kohën e duhur informacionet e kërkuara zyrtarisht.
3. U realizua proçesi i promovimit dhe advokimit, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proçeseve monitoruese.

Ky projekt, e nisi punën me organizimin e seancave informuese me përfaqësuesit e organizatave partnere në 5 bashkitë nën monitorim, bazuar në udhëzuesi për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të realizuar nga GADC në nëntor 2019 Përvec manualit u hartuan skedat monitoruese bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të cilat u përdorën gjatë proçesit të monitorimit

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;

¹ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Gjatë procesit të monitorimit të bashkive Fier, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Kamëz QAGJZh bashkëpunoi me një pjesë të organizatave të Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh , si dhe me disa organizata të tjera të cilat veprojnë në territorin e bashkive nën monitorim si: Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re Fier, Tjetër vizion, Elbasan dhe Shoqata për Integrimin e Zonave Informale.

Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktimat të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatojmë një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Një eksperte lokale u përzgjedh për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2019.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njëzuar koordinatorin vendor të dhunës

pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.

2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
 - Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
 - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
 - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
 - Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikën për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t’i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje,

fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën ëëë.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Të dhëna të përgjithshme për Bashkinë Fier

Sipas Censurit të vitit 2011 në territorin e bashkisë së re banojnë 120.655 qytetarë ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banorë 196.324 njerëz. Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 194.6 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil, densiteti është 316.70 banorë/km². Sipërfaqja e bashkisë është 619.9 km².

Kjo bashki përbëhet nga dhjetë njësi administrative, të cilat janë: Fier, Cakran, Mbrostar Ura, Libofshë, Qendër, Dërmenas, Topojë, Levan, Frrakull dhe Portëz. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Fierit dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019.

Gjetjet kryesore

- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit pranë bashkisë Fier gjatë vitit 2019 ka trajtuar në mënyrë të bashkërenduar vetëm 4 raste të viktimave të dhunës në familje.
- Për periudhën janar – dhjetor 2019 në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Fier janë regjistruar 220 kërkesë padi me objekt lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe Urdhërit të Mbrojtjes. Në të njëjtën periudhë kohore pranë kësaj gjykate janë regjistruar 54 çështje penale me akuzën “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.
- Pranë Zyrës së Shërbimit të Provës Fier gjatë vitit 2019 janë regjistruar 42 raste, vepra penale të parashikuara nga neni 130/a/1, 130/a/3, 130/a/4.²

² **Neni 130/a Dhuna në familje** (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 17; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 33) – 130/a1Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. 130/a2Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e

- Shërbimi i Përmbartimit vijon të mbetet problematikë në funksionim për faktin se për të regjistruar dhe vazhduar procedurat e mëtejshme, pranë kësaj zyre duhet të paraqitet vetë viktimat, fakt ky që neglizhohet. Në shumicën e rasteve viktimat nuk e kanë këtë informacion dhe në ato pak raste që kanë dijeni nuk e kanë mundësinë e paraqitjes.
- Në rastet kur viktimat dhe dhunës në familje referohet nga koordinatori vendore pranë gjykatës për UM/UMM nuk kërkohet nga gjykatësi raporti mjeko-ligjor, prandaj dhe kjo praktikë ka vijuar e njëjtë nga koordinatori pranë kësaj bashkie. Nga ana tjetër, kur rastet referohen nga policia ato shoqërohen edhe me raportin mjeko-ligjor, por rastet e përdorimit të mjekut ligjor janë shumë të rralla.
- Për periudhën Janar – Dhjetor 2019 janë rregjistruar 255 raste dhune në familje pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.
- Numëri i ulët i arrestimit të autorëve, dhunues në familje me vetëm 22 arrestime, 11 persona të ndaluar dhe 4 të shpallur në kërkim.
- Për vitin 2019 buxheti i Bashkisë Fier për MKR Fier është 808 000 lekë. Në këtë shumë përfshihet rroga e koordinatores vendore si dhe shpenzime për organizim aktivitetesh.
- Mekanizmi i Referimit në Bashkinë Fier është mbledhur çdo 3 muaj (Mars, Qershor, Tetor, Nëntor) 2019, gjithsej 4 (katër herë) mbledhje të GTN-së dhe asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues. Gjatë këtyre mbledhjeve janë trajtuar 4 raste të dhunës në familje, ndërkohë që në total koordinatori vendore ka referuar 100 raste për vitin 2019.
- Në kuadër të ndryshimeve në Ligjin Nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” aktorët e mekanizmit të referimit si të Bashkisë Fier, po ashtu dhe të Njësisë Administrative janë trajtuar në Ëorkshopin me temë “Informimi dhe diskutime mbi ligjin Nr. 47/2018 (ndryshimet në Ligjin e Dhunës) dhe sfidat në zbatimin e tij”, *organizuar nga PNUDI dhe MSHMS*
- Bashkia Fier ka organizuar 15 aktivitete (fushata ndërgjegjësuëse, takime dhe organizime të përbashkëta me aktorë të tjerë lokale) për sensibilizimin e komunitetit kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Fier

Të dhëna nga Mekanizmi i Referimit - Bashkia Fier

Mekanizmi i Referimit kryesisht vendoset pranë Bashkive. Koordinatorja Vendore është hallka kryesore e këtij mekanizmi. Ajo ka funksionin edhe të menaxherit të rastit të dhunës në familje. Ajo koordinon punën e Grupit Teknik Ndërdisciplinor (GTN) dhe shërben si ndërmjetëse për institucionet dhe organizatat që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara.

Mekanizmi i Referimit kundër dhunës në Familje pranë Bashkisë Fier, për periudhën janar – dhjetor 2019 ka referuar 100 raste, nga këto, 87 raste me UM dhe 35 me UMM. Sipas koordinatores në MR pothuajse në të gjithë këto raste (87) ajo ka asistuar në plotësimin e kërkesë padisë për UM dhe UMM.

Duke mos cënuar të dhënat personale, në tabelën vijuese paraqiten disa nga rastet që MKR Fier ka trajtuar gjatë vitit 2019.

Tabela 1. Raste dhune të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit Bashkia Fier

integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. 130/a3 Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. 130/a4 Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

Raste te trajtuara nga Mekanizimi i Referrimit	Përshkrimi i rastit
Viktimë e dhunës në familje me 4 fëmijë	12.02. 2019. Viktima ndodhej në një klimë dhune të vazhdueshme fizike dhe psikologjike nga bashkëshorti.. Situata ishte bërë e padurueshme dhe frika për pasojat ishte shtuar shumë së fundmi. Kjo ishte arsyeja që nëna e 4 fëmijëve i'u drejtua Mekanizimit të Referimit kundër dhunës në familje Bashkia Fier për të kërkuar mbështetje për zgjidhjen e kësaj shtate. Nga ana e Mekanizimit të referimit ky rast u trajtua dhe u diskutua edhe me aktorët e tjerë lokalë dhe u kërkuua Urdhër i Menjëhershëm i Mbrojtjes.
Viktimë dhune fizike e psikologjike. Nënë e 4 fëmijëve.	Prill 2019. Viktima ishte e tronditur, e kërcënuar për jetën dhe e frikësuar për fëmijët e saj. Ajo ankohej që bashkëshorti i saj e dhunonte vazhdimisht edhe në sy të fëmijëve duke e bërë të padurueshme jetesën. Ajo ndihej në çdo moment e kërcënuar për jetën. Edhe gjumin natën e kishte të ç'rregullt nga frika se mund të ndodhte më e keqja. Viktima ka qenë edhe një vit më parë me UM, moment kur kishte përfituar njëkohësisht edhe divorcin. Raportimi i rastit për herë të dytë ka ardhur si pasojë se ish bashkëshorti/dhunues nuk ka reshtur nga kërcënimet deri me jetë, duke kërcënuar dhe me heqjen e fëmijëve nga nëna përgjithmonë. Në këto kushte ajo ndihej e pashpresë dhe nën kërcënim që nuk do të mbaronte kurrë, duke kërkuar përsëritje të UM.
Viktimë e dhunës në familje me 2 fëmijë	26 nentor 2019. E divorcuar dhe kishte dhune fizike dhe psikologjike nga ish bashkëshorti. Viktima nuk ishte banuese e Fierit por e Patosit. Megjithatë MR e trajtoi si rast dhe e ndoqi deri në marrjen e UM. E dhunuara kishte hyrë në një fazë pothuajse depresive nga frika e bashkëshortit të saj, i cili kishte filluar të ushtronte dhunë psikologjike të fortë edhe tek fëmijët e mitur. Për këtë arsye, gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatë, dhunuesit i'u kërkuua që të mos i afrohej as fëmijëve.
Viktimë e dhunës në familje me 2 fëmijë	15 tetor 2019. Dhune psikologjike nga bashkëshorti dhe familjaret e tij. Viktima ndihej nën presion dhe me frikën e vazhdueshme të kërcënimit të ekzistencës. Duke qenë në një ambient ku ajo identifikohet si shaktare e zënkave dhe problemeve edhe nga familjarët e bashkëshortit të saj, viktima nuk kishte shpresë se mund të ndryshonte gjë, duke qenë gjithmonë eparagjykuar për çdo veprim dhe shënjestra e të gjitha sharjeve, kërcënimeve dhe gjykimeve pa shkak. Kjo atmosferë e nderë familjare është transmetuar edhe tek dy fëmijët e saj. Frika se mos humbiste fëmijët dhe frika për jetën bënë që ajo të kërkonte ndihmën e drejtësisë.

Burimi: Zyra për barazinë me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

Të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policisë, Bashkia Fier

Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Fier ka në përbërjen e saj 3 komisarate: Komisarati i Policisë Fier, Lushnje e Mallakastër dhe 3 stacione policore: Patos, Roskovec, Divjakë. Të gjitha të dhënat mblidhen e përpunohen në Drejtorinë Vendore të Policisë së qarkut Fier.

Në Bashkinë Fier për periudhën janar – dhjetor 2019 janë evidentuar 255 raste dhune në familje pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, të dhëna që janë përmbledhur dhe marrë nga komisarati qendër pranë kësaj bashkie. Ndërkohë që u paraqitën nga viktimat e dhunës 158 kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje. Në rastet e kërkesë padive pranë drejtorisë së policisë së kësaj bashkie qartazi pasqyrohen edhe rastet e shkeljes së UM apo UMM nga dhunuesit kundrejt viktimave, specifikisht në 10 raste. Gjithashtu vërehet

një numër i ulët i arrestimit të autorëve, dhunues në familje me vetëm 22 arrestime, 11 persona të ndaluar dhe 4 të shpallur në kërkim. Të dhëna më të hollësishme paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Policisë, Bashkia Fier

Përshkrimi	Komisariati Fier
Evidentuar	255
Të dëmtuar gjithsej	261
Prej tyre gra/vajza	185
Kërkesë për U. Mbrojtje	158
Shkelje e U. Mbrojtjes	10
V. P. Neni 130/a	73
Arrest. për 130/a	22
Ndaluar për 130/a	11
Gjendje të Lirë për 130/a	42
Në kërkim për 130/a	4
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Të dhënat nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier

Për periudhën janar – dhjetor 2019, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier janë regjistruar 220 kërkesë padi me objekt lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) dhe Urdhërit të Mbrojtjes (UM). Për të njëjtën periudhë kjo gjykatë ka lëshuar në total 216 UMM dhe UM.

Përgjatë vitit 2019, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier janë regjistruar 54 çështje penale për akuzën Dhunë në familje, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, nga të cilat 50 kanë përfunduar.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Fier ka organizuar fushata ndërgjegjësuese, takime dhe organizime të përbashkëta me aktorë të tjerë lokale për sensibilizimin e komunitetit kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Fushatat dhe takimet janë fokusuar kryesisht nëpër shkollat, aty ku dhe formësohet brezi i ardhshëm si dhe pjesa më e prekur nga ky fenomen.

Janë organizuar 8 aktivitete ndërgjegjësuese dhe takime në shkollat e Bashkisë Fier

- 1 marshim masiv kundër dhunës me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve lokalë dhe komunitetit.
- 1 ekspozitë pikturash e fotografike rreth kësaj teme, me mesazhe sensibilizuese dalë nga vetë të rinjtë.
- 1 festival talentesh në bashkëpunim me qendrën rinore “Epoka e Re” (zëri i të rinjve) me të njëjtin fokus.

- Takime periodike me anëtarët e Grupit Teknik Ndërsektorial.
- Paraqitje filmash me metrazh të shkurter

Për këto aktivitete u vunë në dispozicion nga bashkia Fier 100 000 (njqind mijë lekë). Gjithmonë takimet kanë qenë masive me pjesëmarrjen e të rinjve, aktorëve lokalë, institucioneve të ndryshme lokale dhe komunitetit. Target grupi më i synuar janë gjithmonë të rinjtë. Ndërkohë që 2 ishin aktivitetet që u koordinuan dhe realizuan gjatë vitit 2019 nga organizatat e shoqërisë civile në bashkëpunim.

- Qendra Sociale “Murialdo”,
- Qendra Rinore “Epokae Re”,
- ENGIM

Në fillim të vitit 2019, bashkia e Fierit ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit pranë kësaj bashkie dhe operimi dhe funksionaliteti i MKR-së bazohet në këtë marrëveshje. Gjatë këtij viti nuk ka patur trajnime të përbashkëta për të gjithë anëtarët e mekanizmit në lidhje me dhunën në familje. Gjithashtu, as punonjësit e bashkisë nuk kanë marrë ndonjë trajnim në lidhje me këtë çështje organizuar apo mbështetur nga bashkia. I vetmi trajnim përgjatë vitit 2019 është zhvilluar në muajin qershor me mbështetjen e PNUD dhe kishte në qendër të tij ecurinë dhe rritjen e përgjegjësisë së aktorëve lokalë.

Bashkia Fier liston vetëm PNUD në Shqipëri si ogranizatë ndërkombëtare me të cilën bashkëpunon dhe ka mbështetje. Nga ana tjetër, kjo bashki ka patur koordinim dhe bashkëpunim organizatat me bazë fetare për trajnim dhe organizim të aktiviteteve të përbashkëta por në lidhje me përfshirjen sociale dhe jo specifikisht për barazinë gjinore apo kundër dhunës në familje, sic janë Kisha Ortodokse apo Qendra Selam.

Tabela 3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1	26.01.2019	Shkolla e Mesme “Janaq Klica”	Takim me fokus informimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve kundër dhunës në familje.	Bashkia Fier, DAR
2	21.02.2019	Shkolla e Mesme Libofshë	Ndryshimi vjen nga JU. Takim sensibilizues me nxënësit e shkollave të mesme.	Bashkia Fier, DAR
3	23.02.2019	Shkolla e Mesme Levan	Ndryshimi vjen nga JU. Takim sensibilizues me nxënësit e shkollave të mesme.	Bashkia Fier, DAR
4	27.02.2019	Shkolla e Mesme Cakran	Ndryshimi vjen nga JU. Takim sensibilizues me nxënësit e shkollave të mesme.	Bashkia Fier, DAR
5	5.03.2019	Shkolla e Mesme Fermë	Ndryshimi vjen nga JU. Takim sensibilizues me nxënësit e shkollave të mesme.	Bashkia Fier, DAR
	12.03.2019	Shkolla 9 vjeçare “Jani Bakalli”	Takim sensibilizues me nxënësit e shkollave 9 vjeçare. Informim mbi shkaqet dhe pasojat e dhunës dhe	Bashkia Fier, DAR

			si të parandalojmë dhe raportojmë atë	
4	25.04.2019	Shkolla 9 vjeçare "Pinellopi Pirro"	Takim sensibilizues me nxënësit e shkollave 9 vjeçare. Informim mbi shkaqet dhe pasojat e dhunës dhe si të parandalojmë dhe raportojmë atë	Bashkia Fier, DAR
5	10.05.2019	Shkolla 9 vjeçare "Mark Dashi"	Takim sensibilizues me nxënësit e shkollave 9 vjeçare. Informim mbi shkaqet dhe pasojat e dhunës dhe si të parandalojmë dhe raportojmë atë	Bashkia Fier, DAR
6	20.11.2019	Qendra komunitare Drizë	Aktivitet ndërgjegjësues nëpërmjet lojërave, agrëtimit dhe diskutimeve kundër dhunës në familje.	Bashkia, Murialdo
7	21.11.2019	Qendra komunitare Levan	Në kuadër të ditës Ndërkombëtare të fëmijëve dhe muajit kundër dhunës në familje.	Bashkia, Murialdo
8	22.11.2019	Shkolla "Perikli Ikonomi"	Takim me fokus informimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve kundër dhunës në familje.	Bashkia Fier, DAR
9	25.11.2019	Pasticeri Ke Buono	Dhuna me baze gjinore	ENGIM, Bashkia, Murialdo
10	25.11.2019	Në qendër të qytetit.(Shëtitoren e qytetit)	Tubim /aktivitet masiv	Bashkia, DAR, Institucionet lokale, komuniteti,
11	10.12.2019	QAK Bashkia Fier	Zeri I te rinjve, (Te drejtet e njeriut, stop dhunes)	Epoka e Re Murialdo Bashkia Fier
12	11.12.2019	Bashkia Fier	Takim me aktoret lokal	BashkiaFier
13	17.12.2019	Shkolla Petro Sota	Takim me fokus informimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve kundër dhunës në familje.	Bashkia Fier, DAR

Burimi: Zyra për barazinë gjinore dhe dhunën në familje.

Tabela 4. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës në bashkëpunim me organizatat fetare

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizuanga:
1		Bashkia Fier	Ne ndihme te familjeve ne nevojë Fokusi femijet	Kisha Ortodokse
2		Sheshi prane parkut te qytetit	Mos hesht! Denonco dhunen.	Qendra Selam

Burimi: Zyra për barazinë me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje

Mekanizmi i Referimit pranë Bashkisë Fier bashkëpunon me të gjithë aktorët lokalë. GTN mbledhet çdo 3 muaj. Për rastet emergjente thirren aktorët që ofrojnë shërbime. Komunikimet janë periodike dhe bashkëpunimi është i mirë dhe korrekt, kryesisht me aktorët kryesorë. Mekanizmi i Referimit pranë Bashkisë Fier ka referuar 100 raste që janë përfaqësuar në gjykatë, prej të cilave 87 kanë marrë Urdhër Mbrojtje, 35 prej tyre Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje. Ky mekanizmi ka asistuar në plotësimin e kërkesës on line për urdhrat e mbrbotjes. Viktimat janë orientuar pranë Zyrës së Punës për shërbimin profesional, janë shoqëruar në polici dhe në spital (në rastet kur ka qenë e nevojshme). Raportimi nga koordinatoresha vendore pranë kësaj bashkie me aktorët e tjerë të mekanizmit bëhet 1 herë në tre muaj. Sistemi REVALB përdoret sa herë ka të dhëna për tu hedhur dhe sa herë ai është funksional, pasi ka patur periudha që ky sistem nuk ka qenë i aksesueshëm. Mosfunksionimi ka ardhur si rezultat i problematikave të vetë sistemit. Ndërkohë që asnjë prej grave të dhunuara nuk ka marrë bonus strehimi nga bashkia, por ato janë orientuar nëpër qendra të ndryshme.

Numri total i Urdhërave të Ekzekutimit të depozituar në Zyrën e Përmbartimit për Vitin 2019 për dhunën në familje është: 87 urdhra mbrojtje nga të cilët 75 UM dhe 12 UMM.³ Hallkat më të dobëta të MKR vazhdojnë të rezultojnë Gjykata, Prokuroria dhe Përmbartimi. Sipas ligjit, kur një Urdhër Mbrojtjeje (UM) ose Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje (UMM) vjen nga gjykata, ai duhet të ekzekutohet menjëherë nga Përmbartimi, por duke mos patur dosjet e veta për rastin, ky i fundit nuk vepron, nëse viktimat e dhunës nuk shkon të regjistrohet vetë atje. Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione dhe OJF të ndryshme në bazë të memorandumeve të bashkëpunimit për referimin e rasteve sipas specifikës së tyre. Zyra e Shërbimit të Provës Fier për vitin 2019 ka punuar në drejtimin e bashkëpunimit me aktorët e tjerë vendorë, me shoqata apo qendra, ku një e tillë është Qendra Sociale “Murialdo”. Shërbimi i provës ka një marrëveshje bashkëpunimi me këtë qendër. Në këtë kuadër janë ndërmarrë disa takime në periudha të ndryshme. Mjekësia ligjore është një tjetër hallkë e mekanizmit e cila funksionon në mënyrë jo të rregullt. Në rastet kur viktimat e dhunës në familje referohet në gjykatë nga koordinatoresha vendore, gjykatësi nuk kërkon raport mjeko-ligjor, prandaj edhe ky dokument as nuk merret dhe as nuk depozitohet. Ndërkohë, kur rastet referohen nga policia, atëherë gjykata kërkon raportet mjeko-ligjore, të cilat i bashkangjiten dosjes. Por, sipas monitorimit dhe informacionit të marrë, këto raste janë shumë të rralla, dhe në shumicën e rasteve nuk kërkohet raporti mjeko-ligjor. Koordinatore vendore e MKR pranë kësaj bashkie është znj. Natasha Sollaku, Specialiste për barazinë gjinore dhe dhunën në familje. Kryen detyrat sipas ligjit Ligji 9669 dt. 18.12.2006 “për masat në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Znj. Sollaku ka marrë trajnime nga: PNUD, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Shëndetësisë, ASPA- për profilin e saj të punës. Buxheti i bashkisë në masën 808000 lekë mbulon pagën e koordinatoreshës kundër dhunës, materile zyre si dhe aktivitete të ndryshme për të cilat gjatë vitit 2019 u harxhuan 100000 lekë. Në përgjithësi, bashkëpunimi i bashkisë Fier me Policinë, Zyrën e Punësimit, Drejtorinë Arsimore, me Shërbimin Social ka qenë shumë i mirë përgjatë vitit 2019. Ky bashkëpunim qartazi pasqyrohet edhe në procesverbalet e mbledhjeve të Grupit Teknik Ndërdisciplinar. Vlen të përmendet se megjithë përmirësimet në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, për shkak të angazhimeve të tjera të rëndësishme, titullarët e institucioneve lokalë shpesh nuk marrin pjesë në mbledhjet që zhvillon MKR, për politikën e menaxhimit të rasteve të DHF&DHGJ, duke u përfaqësuar me punonjës të deleguar që mund të mos jenë kompetentë dhe të informuar për çështjet që do të diskutohen.

Përgjatë vitit 2019 janë mbajtur dhe organizuar 4 mbledhje GTN. Për të vërtetuar bashkëpunimet e mësipërme për rastet e dhunës në familje janë procesverbalet të cilat i disponon koordinatori i

³ Burimi: Zyra për barazinë gjinore dhe dhunën në familje Bashkia Fier

Mekanizmit të Referimit pranë Bashkisë Fier. Në këto mbledhje janë trajtuar 4 raste të viktimave të dhunës në familje dhe është proceduar në dhënien e ndihmës dhe gjetjen e zgjidhjeve alternative sipas problematikave. Ndërkohë që në total koordinatorja vendore pranë kësaj bashkie ka referuar rreth 100 raste gjatë vitit 2019.

Tabela 5. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2019 në Bashkinë Fier

Viti	Mbledhjet e GTN
2019	Mars 2019: Mbledhja e parë U trajtuan disa raste dhune të akumuluar gjatë 3 mujorit të parë 2019. Në këtë mbledhje u diskutuan disa raste dhe u rakorduan detyrat/veprimet për vitin në vazhdim.
	Qershor 2019: Mbledhja e dytë U diskutua ecuria e punëve, u mbajt lidhja e kontakteve dhe bashkëveprime si dhe u diskutua mbi nevojën e një qendre për rehabilitimin e viktimave. Në këtë mbledhje u diskutua gjithashtu një rast dhune i përsëritur.
	Tetor 2019: Mbledhja e tretë U trajtuan rastet emergjente me aktorë që ofronin shërbime për rastin: Policia, Shërbimi Social, NjMF, Spitali dhe Zyra e Punës.
	Nëntor 2019: Mbledhja e katërt U trajtuan rastet e dhunës të akumuluar gjatë 3 mujorit.

Tabela 6. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Fier

Viti	Mbledhjet e KD
2019	0 (ishte parashikuar për tu mbledhur KD e vitit 2019 në fund të muajit nëntor ose fillim të muajit janar, por tërmeti i 26 nëntorit e bëri të pamundur këtë takim)

Burimi: Zyra për barazim me baze gjinore dhe dhunën në familje.

Tabela 7. Përbërja e Komitetit Drejtues të bashkisë Fier

Institucioni	Emërbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Armando Subashi
Drejtoria e Policisë	Andon Marko
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Matilda Shalla
Prokuroria e Rrethit	Violeta Marku
Drejtoria Arsimore Rajonale	Brunilda Dhamo
Drejtoria e Shëndetit Publik	Kreshnik ternova
Zyra e Përmbartimit	Julian Prifti
Prefektura	Baki Bala
Zyra e Punës	Nustret Avdulla
Sherbimi social	Mirela Pitushi
Sherbimi profesional	Aleksander Lala
Spitali	Nevila Shuke

Burimi: Zyra për barazim me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

Tabela 8. Përbërja e GTN-së Bashkia Fier viti 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Natasha Sollaku

Drejtoria e Policisë	Enkelejda Akllkanjari, Elisa Velaj
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Elvira Tartaraj
Prokuroria e Rrethit	Eni Begaj
Drejtoria Arsimore Rajonale	Mimoza Lamce
Drejtoria e Shëndetit Publik	Irma Papingu
Zyra e Përmbartimit	Arjan Çepele
Prefektura	Arben Velo
Kryetarët e Njësisë Administrative (Administratorët Social)	Qendër-Fatbardha Prifti/Eduard Mile Dërmënasi-Dilaver Shyti/Marsela Tafa Topojë-Aleksandër Kola /Shpëtim Duraj Libofshë- Themie Doko/Fabiola Vallja Mbrostar-Gëzim Dhima/Mustafa Hebeja Portëz – Agim Brahimllari/Pëllumb Resulaj Levan – Ahmet Bahaj/ Eni Bida Frakull – Dashnor Troka/ Hysni Kapaj Cakran – Tonin Xhela/Alma Avdulaj Rajoni 1 - Maksim Zarka/Drionadla Toska Rajoni 2 - Eduard Sollaku/Marjeta Durmishi Rajoni 3 - Astrit Muhaj/Florida Taraj Rajoni 4 - Ermelinda Çepele/Rajmonda Mehmeti
Zyra e Punësimit	Merita Pove
Organizata Jo qeveritare	Kristina Korrado, Elvi Daka
Strehëzat për viktimat e dhunës	S'ka në qarkun Fier
Komunitete fetare	Ingrida Vida (Kisha ortodokse), Elona Durmishaj (qendra Selam)
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Zenun Hadërmataj
Spitali	Enkeleda Bala
Sherbimi social	Valbona Buzi

Burimi: Zyra për barazinë me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara

216 ishte numri i UM/UMM të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier përgjatë vitit 2019 megjithëse kërkesat e depozituara ishin 220. Kjo vjen si pasojë e shqyrtimit të rasteve, mbledhjes së provave dhe përllogaritjes së riskut. Duhet patur parasysh që të dhënat statistikore nga Policia Vendore e Fierit pasqyrojnë rastet e evidentuara në rang bashkie, ndërsa të dhënat statistikore të paraqitura nga gjykata e këtij rrethi janë rastet e përllogaritura dhe të regjistruara për të gjithë rrethin e Fierit.

Në pjesën më të madhe të rasteve kërkesat për UM/UMM evidentohen direkt në polici koordinitorja vendore asiston në plotësimin e kërkesë padive. Bashkëpunimi me Shërbimin e Provës ka qenë i suksesshem. Ata kanë aplikuar disa shërbime alternative për dhunuesit si: pastrim të ambienteve publike (rruge), shërbim në azile etj. Dhunuesit të mitur trajtohen tek qendra “Horizont” (qendra e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara), ndërsa për gratë dhe burrat dhunues përdoren të njëjtat trajtime si me të dënuarit e tjerë. Për periudhën janar – dhjetor 2019 në Zyrën e Shërbimit të Provës Fier janë regjistruar 42 raste vepër penale të parashikuara nga neni 130/a/1, 130/a/3, 130/a/4. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit janë ekzekutuar vetëm 12 raste në lidhje me UM dhe UMM. Kjo bashki nuk ka programe të mirëfillta dhe të specializuara për rehabilitimin e dhunuesve dhe për dhënien e mundësisë

për ta. Mungesë kjo që e bën edhe më të vështirë përmbushjen e këtij objekti. Ndërkohë që në territorin e kësaj bashkie nuk ka as organizata të shoqërisë civile që mund ta ofrojnë këtë shërbim. Ndaj për bashkinë Fier mbetet qartazi i papërmbushur objekti 3.3 për sa i përket dhënies së mundësisë për rehabilitimin e dhunuesve përmes programeve të specializuara, megjithë qendra “Murialdo” përgjatë vitit 2019 ka arritur të ofrojë kurs profesional 9-mujor për një dhunues të rritur, duke qenë se më së shumti ofron rehabilitim të dhunuesve të mitur.

Konkluzione

- Pranë bashkisë Fier mungon një qendër rehabilitimi apo/dhe një strehëz për viktimat e dhunës në familje, duke sjellë kështu një pengesë të madhe për trajtimin e kësaj kategorie.
- Megjithë përpjekjet e Zyrës së Punës në bashkëpunim me koordinatoren vendore, riaftësimi profesional i viktimave ecën me një ritëm të avashtë, kjo duke sjellë edhe më shumë varfërinë dhe duke mos arritur dot në pavarësinë ekonomike. Në vitin e fundit biznesi social “Murialdo” ka përparuar më shumë në lidhje me këtë çështje, duke ofruar kurse profesionale pa pagesë për gratë e dhunuara dhe më pas duke i punësuar ato.
- Grupi Teknik Ndërsektorial është mbledhur shumë pak gjatë gjithë vitit, dhe ky është një tregues që ky grup nuk funksionon ashtu siç duhet dhe gjithashtu nxjerr në dukje që për të gjitha rastet e tjera të trajtuara plotësisht apo pjesërisht peshën më të madhe e mban koordinatori vendore dhe policia.
- Komiteti Drejtues nuk është mbledhur asnjëherë përgjatë këtij viti, duke mos rishikuar apo trajtuar politika të nevojshme për mirëfunksionimin e Mekanizmit të Referimit Fier. Mungesa e këtyre takimeve sjell edhe një lloj papërgjegjësie nga ana e anëtarëve të këtij mekanizmi edhe për pjesëmarrjen në mbledhje të grupit bërthamë të GTN-së.
- Mungesa e fondeve të alokuara nga bashkia Fier sjell pengesa të mëdha sa i përket ndërgjegjësimit të popullatës për të mos pranuar dhunën apo edhe për informimin e grave dhe vajzave në mënyrë periodike se ku mund të drejtohen në rast dhune. MKR i kësaj bashkie paraqitet i largët me qasjen në komunitetin dhe kjo e bën të padukshëm për target grupet e riskuara.
- Në mënyrë të vazhdueshme, në këtë bashki numri më i madh i aktiviteteve ndërgjegjësuere zhvillohet nga organizatat e shoqërisë civile, kjo edhe për faktin e buxhetit të limituar që ka kjo bashki në lidhje me MKR.
- Mungesa e takimeve periodike, qofshin ato ndërgjegjësuere qofshin seanca psikologjike, bën që viktimat e dhunës në familje të mbeten në ndrydhura edhe të pambrojtura edhe nga mentaliteti që mbizotëron jo vetëm në këtë bashki por në të gjithë vendin.
- Monitorimi I ndërmarrë për këtë bashki ka vënë në lëvizje Mekanizmin e Referimit dhe koordinatoren vendore për të funksionuar në mënyrë të drejtë dhe më të plotë krahasuar me fillimet e monitorimit.

Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Fier

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Fierit për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të

Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Fier dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Rekomandohet që në mënyrë sa më të shpejtë dhe imediate të bëhet ngritja e qendrës së rehabilitimit dhe strehëzave për viktimat e dhunës në familje.
- Nxitje e riaftësimimit personal dhe profesional i viktimave, me qëllim fitimin e pavarësisë personale dhe ekonomike.
- GTN duhet të mblidhet më shpesh dhe të ndjekë rastet deri në momentin e sigurisë së viktimës së dhunës në familje.
- Komiteti Drejtues duhet të mblidhet sepse është e nevojshme rishikimi i politikave dhe mirëfunksionimit të Mekanizmit të Referimit Fier.
- Mekanizmi i Referimit duhet të informojë dhe të qaset pranë komunitetit për të informuar që egziston si hallkë e rëndësishme për mbrojtjen dhe
- Bashkia Fier duhet të alokojë buxhet më të plotë për të përkrahur shërbimeve të kësaj kategorie si edhe alokim fondesh për informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për të mos pranuar dhunën në familje apo atë me bazë gjinore.
- Mekanizmi i Referimit pranë kësaj bashkie duhet të ketë programe periodike të mirëenduara edhe me bashkinë sidomos për realizimin e aktiviteteve.
- Duhet të merren masa për takime periodike (seanca psikologjike në grup) për viktimat e dhunës me qëllim heqjen e barrierës që ato/a kanë ndërlidhur nga mentaliteti.
- Nxitje e një bashkepunimi më të mirë dhe efikas ndërmjet Gjykatës dhe Përmbartimit për një ekzekutim në kohë të vendimeve.
- Rakordim më të mirë të veprimeve mes institucioneve kryesore: Bashki, Polici, Gjykatë, Përmbartim, Prokurori (pasi të dhënat mes tyre rezultojnë të ndryshme edhe pse specifikat janë të ndryshme).

Për më shumë informacion në lidhje me këtë raport kontaktoni

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

E-mail: gadc@gadc.org.al

Adresa: Rr. “Abdyl Frasheri” Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tiranë